



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.____.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatori Ekonomik: “LA - OR” Sh.p.k, me numër Nipt-i: K71420003R,

Me adresë: Tiranë, Berzhitë, Autostrada Tiranë – Elbasan, Km.6, “PALMA NOVA”,

Procedura e prokurimit: “E Hapur - Punë”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: REF-82287-12-15-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat”, me fond limit: **1 037 628 809.16 (një miliard e tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e nëntë pikë gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH** nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2021 në vlerën: 207 525 761.66 (dyqind e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, për vitin 2022 në vlerën: 103 762 880.83 (njëqind e tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë pikë tetëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH** për vitin 2023 në vlerën: 103 762 880.83 (njëqind e tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë pikë tetëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, dhe për vitin 2024 në vlerën: 622 577 285.84 (gjashtëqind e njëzet e dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH**, me afat realizimi të punimeve: **30 (tridhjetë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.****

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 122, datë 21 Dhjetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “LA - OR” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71420003R**
Vlera: **1 035 619 748.95** (një miliard e tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë pikë nëntëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH.**
2. Operatori Ekonomik: “EVEREST” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J78311921L**

Vlera: **1 037 429 006.37** (një miliard e tridhjetë e shtatë milion e katërqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtë pikë tridhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH.**

3. Operatori Ekonomik: **“GJOKA KONSTRUKSION”** Sh.A., me numër Nipt-i: **J91815014U**

Vlera: **1 037 528 809.16** (një miliard e tridhjetë e shtatë milion e pesëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e nëntë pikë gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: **“EVEREST”** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J78311921L**

2. Operatori Ekonomik: **“GJOKA KONSTRUKSION”** Sh.A., me numër Nipt-i: **J91815014U**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria **“EVEREST”** Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “b” dhe “ç”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

“1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se: Deklarata mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7 nuk është e plotë, dhe nuk është paraqitur Deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10.**

II. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.4/ 2.3 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.2.4 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2019 dhe 2020 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, si dhe një vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Mat.

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Mat.**

III. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.3.1 (Përvoja të mëparshme)

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** (që i korrespondon vlerës 518 814 404.58 lekë) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** (që i korrespondon vlerës 2 075 257 618.32 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:...

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon punë të ngjashme për një objekt të vetëm jo më e vogël se 50% e fondit limit, ose punë të ngjashme ku vlera totale e punimeve të kryera gjatë 3 viteve të fundit të jetë jo më e vogël se 200 % e fondit limit, ku kontratat e paraqitura nga ana juaj kanë një vlerë më të vogël, se vlerat e kërkuara në gjurmën “a” dhe “b”.**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:...

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:...**
 - **Kategoria NP-5 (Punime nëntoksore, ura e vepra arti) – Klasifikimi E**
 - **Kategoria NP-7 (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje) – Klasifikimi G**
 - **Kategoria NP-9 (Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe...) – Klasifikimi E**
 - **Kategoria NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit) – Klasifikimi E**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:...**
 - **Kategoria NS-6 (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese) – Klasifikimi D**
 - **Kategoria NS-9 (Punime strukturorë speciale) – Klasifikimi F**
 - **Kategoria NS-16 (Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij) – Klasifikimi C**
 - **Kategoria NS-18 (Punime topogjeodezike) – Klasifikimi D**
 - **Kategoria NS-20 (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë) – Klasifikimi C**

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon për punimet e përgjithshme: klasifikimin E për Kategorinë NP-5, klasifikimin G për Kategorinë NP-7, klasifikimin E për Kategorinë NP-9, klasifikimin E për Kategorinë NP-12, për punimet speciale: klasifikimin D për Kategorinë NS-6, klasifikimin F për Kategorinë NS-9, klasifikimin C për Kategorinë NS-16, klasifikimin D për Kategorinë NS-18, dhe Kategorinë NS-20, të liçencës profesionale.**

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçencat:

- *Liçencë lidhur me ndikimin në mjedis, Kodi III.2.A*
- *Liçencë për grumbullim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme, Kodi III.2.B*
- *Liçencë për mbrojtjen nga zjarri, Kodi I.2.A*
- *Leje mjedisore e tipit C për “Magazinin dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane”, Kodi III.1.A (lëshuar nga QKB)*
- *Liçencë për “Shpues profesionist për ujë”, Kodi III.7.B (lëshuar nga QKB)*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik të paktën njëri nga operatorët ekonomik në bashkim të disponojë liçencat e mësipërme (lëshuar nga QKL/QKB)

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon:**
- **Liçencë lidhur me ndikimin në mjedis, Kodi III.2.A**
- **Liçencë për mbrojtjen nga zjarri, Kodi I.2.A**
- **Leje mjedisore e tipit C për “Magazinin dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane”, Kodi III.1.A (lëshuar nga QKB)**
- **Liçencë për “Shpues profesionist për ujë”, Kodi III.7.B (lëshuar nga QKB)**

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:...

- *ISO 3834-2 (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim)*
- *ISO 28001 (Për sistemin e menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit)*
- *ISO 1452-1 (Sistemi i tubacioneve plastike)*
- *DS CEN 15128 (Sistemi i standarteve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit)*
- *BS EN 13331-1 2002 (Sistemet për veshjen e kanaleve)*
- *Rregullore (EU) nr.333/2011 (Menaxhimi dhe trajtimi i hekurit, çelikut dhe aluminit për skrap)*

ISO-t e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Të gjitha

çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat e mësipërme.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon çertifikatat: ISO 3834-2; ISO 28001; ISO 1452-1; DS CEN 15128; BS EN 13331-1 2002 dhe Rregullore (EU) nr.333/2011.**

VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Tuba PE 100 RC sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike
- Tuba Çeliku sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike Operatori ekonomik duhet të paraqesë:...

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për listën e mallrave/ materialeve (Autorizime, katalog, dëshmi testimi zyrtar etj.).**

VIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar, me afat vlefshmërie në përputhje me afatin e kryerjes së punimeve dhe e vlefshme vetëm për objektin e kësaj kontrate, për analizat e mëposhtme:

- Beton i freskët sipas standardeve SSH EN 206-1: 2013; ASTM C94/C94M 2016a; EN 12350-2 2009 ASTM C143/C143-M15a; SSH EN 12350-6: 2009 ASTM C138/C138M-15; EN 12350-7: 2009 ASTM C231/C231M-14, ose sipas standardeve të përditësuara.
- Beton i ngurtësuar sipas standardeve SSH EN 12390-3:2009; SSH EN 12504-2:2012, SSH EN 12390-5:2009 ASTM C78/C78M-16; SSH EN 12390-6 2009 ASTM C496/C496M-11, ose sipas standardeve të përditësuara
- Çelik sipas standardit SSH EN ISO 6892-1:2009, ose sipas standardeve të përditësuara.
- Agregate për ndërtim SSH EN 933-1: 2012; SSH EN 9338:2012+A1:2015; SSH EN 1097-6:2013; SSH EN 933-3: 2012; SSH EN 1097-2:2010; SSH EN 1097-1:2011; BS 812-110:1990; SSH EN 10973: 2005 ASTM C29/C29M-16 AASHTO T 19-14; SSH EN

13672:2009 ASTM C88-13 AASHTO T 104-02; EN 933-5:2005, ose sipas standardeve të përditësuara.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar.

IX. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “a”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë si drejtues teknik në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune e noterizuar (të vlefshme), diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Transport;
- 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Strukturist;
- 2 (dy) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf**;
- 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Gjeoteknik;
- 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- 1 (një) **Inxhinier Elektrik**
- 1 (një) **Inxhinier Mekanik**
- 2 (dy) **Inxhinier Gjeolog**, nga të cilët 1 (një) të jetë profili Hidrogjeologji;
- 1 (një) **Inxhinier Elektronik**
- 1 (një) **Arkitekt**
- 1 (një) **Inxhinier Mjedisi**, profili Trajtimi i Ujrave

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon staf inxhinierik si drejtues teknik në liçencën e shoqërisë:

- 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Transport;
- 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Strukturist;
- 2 (dy) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf**, por vetëm 1 (një) të tillë
- 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Gjeoteknik;
- 2 (dy) **Inxhinier Gjeolog**, nga të cilët 1 (një) të jetë profili Hidrogjeologji;

X. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “b”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

b) Përveç inxhinierave të kërkuar më lart, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune e noterizuar (të vlefshme), diplomë, çertifikatën përkatëse, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, stafi inxhinierik si më poshtë:

- 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi**, nga të cilët 1 (një) të jetë profili Transport;
 - 2 (dy) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf**;
 - 1 (një) **Inxhinier Mjedis**, profili Trajtimi i Ujrave, i pajisur me çertifikatë “Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit dhe të Mbetjeve”, si dhe i pajisur me çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit;
 - 1 (një) **Inxhinier Elektrik/ Elektronik** i pajisur me çertifikatë për sistemin e SCADA, lëshuar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar kompetente për sistemet SCADA.
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon staf inxhinierik:**
- 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi**, nga të cilët 1 (një) të jetë profili Transport;
 - 2 (dy) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf**;
 - 1 (një) **Inxhinier Mjedis**, profili Trajtimi i Ujrave, i pajisur me çertifikatë “Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit dhe të Mbetjeve”, si dhe i pajisur me çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit;
 - 1 (një) **Inxhinier Elektrik/ Elektronik** i pajisur me çertifikatë për sistemin e SCADA, lëshuar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar kompetente për sistemet SCADA.

XI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “d”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

d) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor – Nëntor 2020, stafi mbështetës si më poshtë:

- 2 (dy) **Teknik Gjeometër**
- 3 (tre) **Teknik Ndërtimi**
- 2 (dy) **Mekanik**
- 1 (një) **Elektriçist**

** Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Dëshmi Aftësie të lëshuar nga subjektet e akredituar/ Diplomë (Dëftesë), Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme) si dhe Kontrata e punës e vlefshme.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon staf mbështetës:**
- 2 (dy) **Teknik Gjeometër**
 - 3 (tre) **Teknik Ndërtimi**, por vetëm 1 (një) të tillë
 - 2 (dy) **Mekanik**
 - **Për 1 (një) Elektriçist nuk është paraqitur Dëshmi Aftësie të lëshuar nga subjektet e akredituar/ Diplomë (Dëftesë)**

XII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “e”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

e) Krahas stafit mbështetës të mësipërm, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar minimumi 75 (shtatëdhjetë e pesë) **punonjës të kualifikuar**, nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin: 10 (dhjetë) Specialistë për Montim Tubash, 2 (dy) Teknik Ndërtimi, 3 (tre) Specialist për testimin e tubave nën presion, 2 (dy) Elektriçist, 3 (tre) Pompist, 7 (shtatë) Hidraulik, 2 (dy) Mekanik, 4 (katër) Saldator, 12 (dymbëdhjetë) karpentier (marangoz), 7 (shtatë) Hekurkthyes, 4 (katër) Hidroizolues, 3 (tre) Murator, 10 (dhjetë) Specialistë ndërtimi, 3 (tre) montator, dhe 3 (tre) Bojaxhi, të pajisur me dëshmi kualifikimi e Sigurimit Teknik (të vlefshme), lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe ligjit nr. 13/2013;

* Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme), kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shtator – Nëntor 2020.

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon punonjësit e kualifikuar:

- 10 (dhjetë) Specialistë për Montim Tubash, por vetëm 3 (tre) të tillë, për të cilët nuk janë paraqitur dhe kontratat e punës
- 2 (dy) Teknik Ndërtimi,
- 3 (tre) Specialist për testimin e tubave nën presion,
- 3 (tre) Pompist,
- 7 (shtatë) Hidraulik, por vetëm 5 (pesë) të tillë;
- 2 (dy) Mekanik, por vetëm 1 (një) të tillë;
- 12 (dymbëdhjetë) karpentier (marangoz) , por vetëm 6 (pesë) të tillë;
- 7 (shtatë) Hekurkthyes, por vetëm 4 (katër) të tillë;
- 10 (dhjetë) Specialistë ndërtimi, por vetëm 3 (tre) të tillë; dhe
- 3 (tre) montator,

XIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “f”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

f) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 9 (nëntë) **punonjës manovratorë të mjeteve të rënda**, nga të cilët 2 (dy) automakinistë dhe 7 (shtatë) eskavatoristë. Për këta punonjës duhet të paraqiten: Kontrata e punës (e vlefshme), Dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga organet kompetente sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shtator – Nëntor 2020.

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon 7 (shtatë) eskavatoristë, por vetë 5 (pesë) të tillë.

XIV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “g”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

g) Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar, minimumi:

- **2 (dy) punonjës, të cilët të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.**
- **2 (dy) punonjës specialist si Ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të certifikuar nga Drejtoria e MZSH-së.**
- **1 (një) Inxhinier Auditues i Energjisë (i pajisur me certifikatë për Auditimin e Energjisë), e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.**
- **2 (dy) punonjës të certifikuar si “Ekspert për Ndhmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”**
- **1 (një) inxhinier “Përgjegjës për dëmet në mjedis” i pajisur me certifikatë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.**
- **1 (një) inxhinier “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001: 2015” i pajisur me certifikatë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

** Për stafin e mësipërm të paraqiten certifikatat përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor – Nëntor 2020*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon personel të certifikuar:**
- **2 (dy) punonjës, të cilët të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, por vetëm 1 (një) të tillë;**
 - **2 (dy) punonjës specialist si Ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të certifikuar nga Drejtoria e MZSH-së, por vetëm 1 (një) të tillë;**
 - **2 (dy) punonjës të certifikuar si “Ekspert për Ndhmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, por vetëm 1 (një) të tillë;**
 - **1 (një) inxhinier “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001: 2015” i pajisur me certifikatë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

XV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “h”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

h) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të certifikuar për punime në lartësi, ku njëri prej të cilëve të jetë inxhinier, si dhe të të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor – Nëntor 2020

** Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Çertifikatat përkatëse për punimet në lartësi, lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe listëpagesat për periudhën e kërkuar.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon në stafin e tij të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të çertifikuar për punime në lartësi, por vetëm 5 (pesë) të tillë, ku njëri prej të cilëve është inxhinier.**

XVI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “i”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

i) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, me eksperiencë pune minimumi 10 (dhjetë) vjet dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin: Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diplomë, CV, Librezë pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur deklaratë për përcaktimin e Drejtuesit Teknik.**

XVII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9 gërma “a” dhe “b”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.9 (Makineri, Pajisje)

- a) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet, mjete dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;...*
- b) *Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:...*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara.**

XVIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.10/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.10 *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve (të ndërtimit dhe inerteve) me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat, ku të pasqyrohet në ekstraktin e shoqërisë ose të qeradhënsit, si dhe duhet të paraqitet:*

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë dhe kontratën noteriale të qerasë në rast se objekti është me qera.
 - Liçencë nga QKL, (Kodi III.2.B) – Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte...
 - Leje Mjedisi e tipit C nga QKL, (Kodi III.1.A) – Magazinimi, ngarkimi...
- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon **1 (një)** njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve (të ndërtimit dhe inerteve) me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat.

XIX. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.11/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **1 (një) kantier për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera (Kontrata Noteriale e Qerasë duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:**

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë, lejen e shfrytëzimit nga organet kompetente) dhe kontratën noteriale të qerasë në rast se kantieri është me qera.
- Leje Mjedisi nga QKL (përkatëse) në përputhje me ligjin.

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon **1 (një) kantier për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera.**

XX. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.12/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për materialet/ pajisjet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i materialeve/ pajisjeve	Specifikimet teknike referuar katalogëve dhe nr. i faqes së katalogëve për çdo pajisje etj., testimet zyrtare	Kompania prodhuese	Çertifikata ISO e prodhuesit (9001: 2008/2015) ose Çertifikatë Konformiteti CE
-----	-----------------------------------	---	--------------------	--

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, i cili të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme, si dhe të japë një përshkrim të plotë të karakteristikave teknike të pajisjeve të përfshira në skedën teknike, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas pasqyrës së mësipërme, **specifikimet teknike (referuar katalogëve dhe nr. i faqes së katalogëve për çdo pajisje/ material etj.) kompaninë prodhuese dhe çertifikatën ISO 9001: 2008/2015 ose Çertifikatën e Konformitetit CE të prodhuesit së bashku me të dhëna të plota të shoqërisë prodhuese, me qëllim verifikimin e**

originës së artikujve dhe të dhënave të tjera të deklaruara. Katalogët duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose angleze.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka dorëzuar skedën teknike për materialet/ pajisjet e kërkuara në tabelën e paraqitur në DST, si dhe bashkëlidhur dokumentacionin përkatës.**

XXI. Nuk është përmbushur përcaktimi i kërkuar në: 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kriteri më poshtë:

Autoriteti Kontraktor do të organizojë një vizitë në kantier 7 (shtatë) ditë përpara datës së zhvillimit të tenderit, ku operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqiten pranë autoritetit kontraktor në orën 8.00, me mostrat e tubacioneve PE 100 RC, shoqëruar me raport testimet përkatëse, si dhe shoqëruar me Çertifikatat ISO të prodhimit. Gjithashtu operatorëve ekonomik të interesuar gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime të nevojshëm nga punonjësit që do të caktohen nga A.K., në lidhje me objektin e investimit, ku do të pajisen dhe me vërtetim nga institucioni (mosparaqitja është kusht s'kualifikimi). Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të vërtetojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar),

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën, ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit, dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi nuk është paraqitur pranë autoritetit kontraktor në vizitën e organizuar së bashku me mostrat e tubacioneve PE 100 RC të kërkuara, si dhe nuk ka deklaruar se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit.**

XXII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.13/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Analizat e çmimeve të preventivit, Plan – organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, me një relacion shpjegues sipas kërkesave të përcaktuara nga KPT dhe KTZ në fuqi, si dhe Grafikun e detajuar të punimeve të firmosur e vulosur nga përfaqësuesi i ofertuesit.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi nuk në dokumentacionin e ngarkuar për tender, nuk ka paraqitur Analizat e çmimeve të preventivit, Plan – organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, me një relacion shpjegues sipas kërkesave të përcaktuara nga KPT dhe KTZ në fuqi, si dhe Grafikun e detajuar të punimeve.**

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “GJOKA KONSTRUKSION” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “b” dhe “ç”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se: në *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur* nuk ka klikuar mënyrën e përgaditjes së ofertës, ndërsa *Deklarata mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike*, nuk është sipas formatit të Shtojcës 5.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.4/ 2.3 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.4 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2019 dhe 2020 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, si dhe një vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Mat.

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur vërtetimet nga Bashkia ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2020, si dhe nuk ka paraqitur vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Mat.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:...

▪ *Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:...*

– *Kategoria NS-3 (Impiante ngritëse dhe transportuese) – Klasifikimi C*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon klasifikimin C për Kategorinë NS-3, për punimet speciale në liçencën profesionale.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçencat:

- Liçencë lidhur me ndikimin në mjedis, Kodi III.2.A
- Liçencë për grumbullim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme, Kodi III.2.B
- Liçencë për mbrojtjen nga zjarri, Kodi I.2.A
- Leje mjedisore e tipit C për “Magazininim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane”, Kodi III.1.A (lëshuar nga QKB)
- Liçencë për “Shpues profesionist për ujë”, Kodi III.7.B (lëshuar nga QKB)

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik të paktën njëri nga operatorët ekonomik në bashkim të disponojë liçencat e mësipërme (lëshuar nga QKL/QKB)

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon:**

- Liçencë lidhur me ndikimin në mjedis, Kodi III.2.A
- Liçencë për mbrojtjen nga zjarri, Kodi I.2.A
- Leje mjedisore e tipit C për “Magazininim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane”, Kodi III.1.A (lëshuar nga QKB)
- Liçencë për “Shpues profesionist për ujë”, Kodi III.7.B (lëshuar nga QKB)

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:...

- ISO 1452-1 (Sistemi i tubacioneve plastike)
- DS CEN 15128 (Sistemi i standarteve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit)
- Rregullore (EU) nr.333/2011 (Menaxhimi dhe trajtimi i hekurit, çelikut dhe aluminit për skrap)

ISO-t e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat e mësipërme.

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon çertifikatat ISO 1452-1; DS CEN 15128 dhe Rregullore (EU) nr.333/2011.**

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Për kapacitetin Teknik:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- *Tuba PE 100 RC sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike*
- *Tuba Çeliku sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike*
Operatori ekonomik duhet të paraqesë:...

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për listën e mallrave/ materialeve (Autorizime, katalog, dëshmi testimi zyre etj.).**

VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar, me afat vlefshmërie në përputhje me afatin e kryerjes së punimeve dhe e vlefshme vetëm për objektin e kësaj kontrate, për analizat e mëposhtme:

- *Beton i freskët sipas standardeve SSH EN 206-1: 2013; ASTM C94/C94M 2016a; EN 12350-2 2009 ASTM C143/C143-M15a; SSH EN 12350-6: 2009 ASTM C138/C138M-15; EN 12350-7: 2009 ASTM C231/C231M-14, ose sipas standardeve të përditësuara.*
- *Beton i ngurtësuar sipas standardeve SSH EN 12390-3:2009; SSH EN 12504-2:2012, SSH EN 12390-5:2009 ASTM C78/C78M-16; SSH EN 12390-6 2009 ASTM C496/C496M-11, ose sipas standardeve të përditësuara*
- *Çelik sipas standardit SSH EN ISO 6892-1:2009, ose sipas standardeve të përditësuara.*
- *Agregate për ndërtim SSH EN 933-1: 2012; SSH EN 9338:2012+A1:2015; SSH EN 1097-6:2013; SSH EN 933-3: 2012; SSH EN 1097-2:2010; SSH EN 1097-1:2011; BS 812-110:1990; SSH EN 10973: 2005 ASTM C29/C29M-16 AASHTO T 19-14; SSH EN 13672:2009 ASTM C88-13 AASHTO T 104-02; EN 933-5:2005, ose sipas standardeve të përditësuara.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar.**

VIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “a”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë si drejtues teknik në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune e noterizuar (të vlefshme), diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Transport;
- 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Strukturist;
- 2 (dy) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf**;
- 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Gjeoteknik;
- 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- 1 (një) **Inxhinier Elektrik**
- 1 (një) **Inxhinier Mekanik**
- 2 (dy) **Inxhinier Gjeolog**, nga të cilët 1 (një) të jetë profili Hidrogeologji;
- 1 (një) **Inxhinier Elektronik**
- 1 (një) **Arkitekt**
- 1 (një) **Inxhinier Mjedisi**, profili Trajtimi i Ujrave

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon staf inxhinierik si drejtues teknik në liçencën e shoqërisë:

- 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Strukturist, por vetëm 1 (një) të tillë
- 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**, profili Gjeoteknik;
- 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- 1 (një) **Inxhinier Elektrik**
- 1 (një) **Inxhinier Gjeolog**, profili Hidrogeologji;
- 1 (një) **Inxhinier Elektronik**

IX. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “b”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

b) Përveç inxhinierave të kërkuar më lart, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune e noterizuar (të vlefshme), diplomë, çertifikatën përkatëse, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, stafi inxhinierik si më poshtë:

- 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi**, nga të cilët 1 (një) të jetë profili Transport;
- 2 (dy) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf**;
- 1 (një) **Inxhinier Mjedisi**, profili Trajtimi i Ujrave, i pajisur me çertifikatë “Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit dhe të Mbetjeve”, si dhe i pajisur me çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit;
- 1 (një) **Inxhinier Elektrik/ Elektronik** i pajisur me çertifikatë për sistemin e SCADA, lëshuar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar kompetente për sistemet SCADA.

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon staf inxhinierik:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, të jetë profili Transport;
- Për të 2 (dy) Inxhinier Gjeodet/ Topograf, mungojnë librezat e punës
- Inxhinieri i Mjedisit, nuk është i profilit Trajtimi i Ujrave, i mungon librezat e punës dhe nuk është i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të mjedisit dhe mbetjeve, dhe
- Të 2 (dy) inxhinieret elektrik nuk janë të pajisur me çertifikatë për sistemin e SCADA;

X. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “d”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

d) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor – Nëntor 2020, stafi mbështetës si më poshtë:

- 2 (dy) **Teknik Gjeometër**
- 3 (tre) **Teknik Ndërtimi**
- 2 (dy) **Mekanik**
- 1 (një) **Elektriçist**

** Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Dëshmi Aftësie të lëshuar nga subjektet e akredituar/ Diplomë (Dëftesë), Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme) si dhe Kontrata e punës e vlefshme.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon staf mbështetës:**

- 2 (dy) **Teknik Gjeometër**
- **Për 3 (tre) Teknik Ndërtimi nuk janë paraqitur Dëshmitë e Aftësisë të lëshuar nga subjektet e akredituar/ Diplomë (Dëftesë)**

XI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “e”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*e) Krahas stafit mbështetës të mësipërm, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar minimumi 75 (shtatëdhjetë e pesë) **punonjës të kualifikuar, nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin: 10 (dhjetë) Specialistë për Montim Tubash, 2 (dy) Teknik Ndërtimi, 3 (tre) Specialist për testimin e tubave nën presion, 2 (dy) Elektriçist, 3 (tre) Pompist, 7 (shtatë) Hidraulik, 2 (dy) Mekanik, 4 (katër) Saldator, 12 (dymbëdhjetë) karpentier (marangoz), 7 (shtatë) Hekurkthyes, 4 (katër) Hidroizolues, 3 (tre) Murator, 10 (dhjetë) Specialistë ndërtimi, 3 (tre) montator, dhe 3 (tre) Bojaxhi, të pajisur me dëshmi kualifikimi e Sigurimit Teknik (të vlefshme), lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe ligjit nr. 13/2013;***

** Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme), kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shtator – Nëntor 2020.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon punonjësit e kualifikuar:**
 - **10 (dhjetë) Specialistë për Montim Tubash,**
 - **3 (tre) Specialist për testimin e tubave nën presion,**
 - **3 (tre) Pompist,**
 - **7 (shtatë) Hidraulik, por vetëm 5 (pesë) të tillë;**
 - **12 (dymbëdhjetë) karpentier (marangoz) , por vetëm 5 (pesë) të tillë;**
 - **7 (shtatë) Hekurkthyes, por vetëm 1 (një) të tillë;**
 - **4 (katër) Hidroizolues,**
 - **3 (tre) Murator, por vetëm 2 (dy) të tillë;**
 - **10 (dhjetë) Specialistë ndërtimi, 3 (tre) montator, dhe 3 (tre) Bojaxhi,**

XII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “g”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

g) Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar, minimumi:

- **2 (dy) punonjës, të cilët të disponojnë çertifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.**
- **2 (dy) punonjës specialist si Ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të çertifikuar nga Drejtoria e MZSH-së.**
- **1 (një) Inxhinier Auditues i Energjisë (i pajisur me çertifikatë për Auditimin e Energjisë), e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.**
- **2 (dy) punonjës të çertifikuar si “Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”**
- **1 (një) inxhinier “Përgjegjës për dëmet në mjedis” i pajisur me çertifikatë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.**
- **1 (një) inxhinier “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001: 2015” i pajisur me çertifikatë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

** Për stafin e mësipërm të paraqiten çertifikatat përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor – Nëntor 2020*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon personel të çertifikuar:**
 - **2 (dy) punonjës specialist si Ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të çertifikuar nga Drejtoria e MZSH-së, por vetëm 1 (një) të tillë;**

- 1 (një) inxhinier “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001: 2015” i pajisur me çertifikatë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

XIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8 gërma “h”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

h) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të çertifikuar për punime në lartësi, ku njëri prej të cilëve të jetë inxhinier, si dhe të të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor – Nëntor 2020

** Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Çertifikatat përkatëse për punimet në lartësi, lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe listëpagesat për periudhën e kërkuar.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon në stafin e tij të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të çertifikuar për punime në lartësi, por vetëm 4 (katër) të tillë, ku njëri prej të cilëve është inxhinier.**

XIV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9 gërma “a”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.9 (Makineri, Pajisje)

- a) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet, mjete dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;...*
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon automjetet, mjetet dhe pajisjet:**
 - 1 (një) Makineri për shkullje pemësh;
 - 1 (një) Makineri speciale për hidrombjellje bari;
 - 3 (tre) Autobot uji, por vetëm 1 (një) të tillë;
 - 4 (katër) Kamioncine me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 (një pikë pesë) ton dhe maksimumi 2 (dy) ton për secilën kamioncinë.
 - 3 (tre) Pompë uji zhytëse
 - 2000 m² Skela metalike
 - 1 (një) Aparaturë për testimin e ngjeshmërisë së materialit me metodë me goditje (me pjtatë) duhet të plotësojë këto parametra: Forca e goditjes (ndikimit): 7070 N; Koha e ndikimit: 17ms; Lartësia e lëshimit: 720 mm; Memorie: 900 matje
 - 2 (dy) Skelë kullë
 - 2000 m² Kallëperi metalike
 - 1 (një) Pajisje prerëse hidraulike për struktura b/a (tip gërshërë)
 - 1 (një) Pajisje për largim ujërash nëntokësore me aksesoret përkatës
 - 1 (një) Mikser Rrotullues 360° me goma

XV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.10/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve (të ndërtimit dhe inerteve) me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat, ku të pasqyrohet në ekstraktin e shoqërisë ose të qeradhënësit, si dhe duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë dhe kontratën noteriale të qerasë në rast se objekti është me qera.
- Liçencë nga QKL, (Kodi III.2.B) – Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte...
- Leje Mjedisi e tipit C nga QKL, (Kodi III.1.A) – Magazinimi, ngarkimi...

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon 1 (një) njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve (të ndërtimit dhe inerteve) me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat.**

XVI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.12/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për materialet/ pajisjet sipas tabelës së mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i materialeve/ pajisjeve</i>	<i>Specifikimet teknike referuar katalogëve dhe nr. i faqes së katalogëve për çdo pajisje etj., testimet zyrtare</i>	<i>Kompania prodhuese</i>	<i>Çertifikata ISO e prodhuesit (9001: 2008/2015) ose Çertifikatë Konformiteti CE</i>
------------	--	--	---------------------------	---

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, i cili të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme, si dhe të japë një përshkrim të plotë të karakteristikave teknike të pajisjeve të përfshira në skedën teknike, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara.*
 - *Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas pasqyrës së mësipërme, **specifikimet teknike** (referuar katalogëve dhe nr. i faqes së katalogëve për çdo pajisje/ material etj.) **kompaninë prodhuese dhe çertifikatën ISO 9001: 2008/2015 ose Çertifikatën e Konformitetit CE të prodhuesit së bashku me të dhëna të plota të shoqërisë prodhuese, me qëllim verifikimin e origjinës së artikujve dhe të dhënave të tjera të deklaruara. Katalogët duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose angleze.***
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka dorëzuar skedën teknike për materialet/ pajisjet e kërkuara në tabelën e paraqitur në DST, si dhe bashkëlidhur**

dokumentacionin përkatës.

XVII. Nuk është përmbushur përcaktimi i kërkuar në: 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kriteri më poshtë:

Autoriteti Kontraktor do të organizojë një vizitë në kantier 7 (shtatë) ditë përpara datës së zhvillimit të tenderit, ku operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqiten pranë autoritetit kontraktor në orën 8.00, me mostrat e tubacioneve PE 100 RC, shoqëruar me raport testimet përkatëse, si dhe shoqëruar me Çertifikatat ISO të prodhimit. Gjithashtu operatorëve ekonomik të interesuar gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime të nevojshëm nga punonjësit që do të caktohen nga A.K., në lidhje me objektin e investimit, ku do të pajisen dhe me vërtetim nga institucioni (mosparaqitja është kusht s'kualifikimi). Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të vërtetojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar),

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën, ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit, dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi nuk është paraqitur pranë autoritetit kontraktor në vizitën e organizuar së bashku me mostrat e tubacioneve PE 100 RC të kërkuara, si dhe nuk ka deklaruar se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit.**

XVIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.13/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Analizat e çmimeve të preventivit, Plan – organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, me një relacion shpjegues sipas kërkesave të përcaktuara nga KPT dhe KTZ në fuqi, si dhe Grafikun e detajuar të punimeve të firmosur e vulosur nga përfaqësuesi i ofertuesit.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi nuk nw dokumentacionin e ngarkuar për tender, nuk ka paraqitur Analizat e çmimeve të preventivit, Plan – organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, me një relacion shpjegues sipas kërkesave të përcaktuara nga KPT dhe KTZ në fuqi.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë **Operatorin Ekonomik: "LA - OR" Sh.p.k**, me numër Nipt-i: **K71420003R**, me **adresë: Tiranë, Berzhitë, Autostrada Tiranë – Elbasan, Km.6, "PALMA NOVA"**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **1 035 619 748.95** (një miliard e tridhjetë e pesë milion

e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë pikë nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **29.01.2021**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR